



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 51/1 Prot.

Tiranë, më 10. 01. 2018

V E N D I M

Nr. 9, Datë 10. 01. 2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa Nr. 126, datë 26.09.2017, e D. H., ku pretendohet për diskriminim për shkak të moshës dhe çdo shkak tjetër, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë (në vijim DRSSH Korçë).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se, me vendim Nr. 2298, datë 08.10.1995, ka përfituar pensionin e pleqërisë nga ana DRSSH-së Korçë. Sipas tij, masa e pensionit është përlogaritur gabim nga ana DRSSH-së Korçë, pasi për vitet që ai ka punuar, ka patur pagë maksimale, ndërkohë që individ të tjerë të cilët kanë patur pagën më të ulët, pensioni i pleqërisë i ka dalë në një masë më të madhe. Për këtë arsye, ankuesi i është drejtuar Komisionit Rajonal të Ankimit Korçë, i cili me vendim nr. 48, datë 20.06.2007, ka lënë në fuqi masën e pensionit të përlogaritur nga ana e DRSSH-së Korçë. Në këto kushte, ankuesi ndjehet i diskriminuar në raport me përfitues të tjerë të pensionit të pleqërisë, për shkak të moshës.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,*

vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar në formularin e ankesës nr. 126, datë 26.09.2017, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të tij, Komisioneri vlerëson se, D. H. është vënë në dijeni për sjelljen diskriminuese të pretenduar nga ana e DRSSH-së Korçë, nëpërmjet vendimit Nr. 48, datë 20.06.2007.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Mbështetur në nenin 86 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; 2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore; 3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar; 4. Këshilli Administrativ përcakton përbërjen, numrin dhe procedurën e funksionimit të Komisionit të Ankimit”, ankuesit i lind e drejta të ndjek rrugën administrative të ankimit, pretendimin e ngritur.

PËR KËTO ARSYE:

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe bazuar në nenin 33, pika 4/dh e Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së D. H., për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Moshë)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)